



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Dhjetor 2020

Nr: 40

**VENDIM**

**PËR CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARËT DHE  
SEKRETARËT E KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR  
PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021**

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 29, paragrafët 1 dhe 4, dhe nenin 183, paragrafi 8, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**V Ë R E N**

Referuar nenit 19, paragrafi 1, shkronja ”n”, të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen atij me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia nje shprehimisht Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Referuar neneve 20 dhe 21, të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në mënyrë shteruese, nuk përcaktohet kompetenca për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarë të KZAZ-ve.

Referuar nenit 29, paragrafi 4, të Kodit Zgjedhor, renditja e partive për efekt të ndarjes së vendeve në KZAZ, bëhet mbi bazën e numrit të mandateve që ka fituar partia politike nga zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë.

Referuar nenit 183, paragrafi 8, të Kodit Zgjedhor, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, e drejta për propozimin e anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve përcaktohet sipas



rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit të Shqipërisë në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve.

Referuar vendimit nr. 555, datë 26.07.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017”, numri i mandateve të fituara nga partitë politike është si më poshtë:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë	74 mandate
2. Partia Demokratike	43 mandate
3. Lëvizja Socialiste për Integrim	19 mandate
4. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	3 mandate
5. Partia Social Demokrate e Shqipërisë	1 mandat

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2107 prot., datë 24.11.2020, i paraqiti Kuvendit të Shqipërisë, kërkesë për dërgimin e informacionit lidhur me konfigurimin shumicë-pakicë të partive parlamentare në çeljen e Kuvendit, menjëherë pas zgjedhjeve të datës 25.06.2017.

Kuvendi i Shqipërisë, me shkresën nr. 2107/1 prot., datë 27.11.2020, informon:

“Bazuar në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 555, datë 26.07.2017 “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017”, partitë parlamentare dhe numri i deputetëve për secilën parti politike menjëherë pas zgjedhjeve kanë qënë konfiguruar si më poshtë:

1. Partia Socialiste	- shumica parlamentare përkatësisht, 74 mandate;
2. Partia Demokratike	- pakica parlamentare përkatësisht, 43 mandate;
3. Lëvizja Socialiste për Integrim	- pakica parlamentare përkatësisht, 19 mandate;
4. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	- pakica parlamentare përkatësisht, 3 mandate;
5. Partia Social Demokrate e Shqipërisë	- pakica parlamentare përkatësisht, 1 mandat.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, realizoi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik gjithëpërfshirës të projektvendimit me palë të interesuara, parti politike dhe organizata të shoqërisë civile.

Partia Demokratike, përmes përfaqësuesit ligjor në KQZ, komentoi si më poshtë:

*“Partia Social Demokrate, e cila në përgjigjen e Kuvendit dhe rrjedhimisht në akt është cilësuar si parti e pakicës parlamentare është qartësisht parti e shumicës parlamentare. Si e tillë ajo është*



*sjellë që në fillim të legjislaturës kur në cdo iniciativë qeverisëse dhe akt të kaluar në Kuvendin e Shqipërisë ajo ka votuar në menyre konsistente në favor të iniciativave të shumicës parlamentare. Është Kuvendi që duhet të qartësojë qëndrimin dhe pozicionimin e Partisë Social Demokratike menjëherë sapo është çelur Kuvendi, në votimin e parë të rëndësishëm të tij, atij të votëbesimit të qeverisë së Partisë Socialiste”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, përmes shkresës nr. 2290 prot., datë 11.12.2020, i kërkoi Kuvendit të Shqipërisë informacion lidhur me komentet e përfaqësuesit të Partisë Demokratike në KQZ.

Kuvendi i Shqipërisë, me shkresën nr. 2290/1prot., datë 21.12.2020, informoi se:

“Kuvendi i Shqipërisë referuar edhe Rregullores së Kuvendit nuk disponon ndonjë akt për pozicionimin e PSD në raport me shumicën apo pakicën parlamentare. Informacioni i dërguar me shkresën tonë 22998, datë 27.11.2020 i referohet numrit të mandateve të fituara nga partitë politike sipas vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 555, datë 26.07.2017 “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Qershor 2017”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për të vendosur drejt dhe në respekt të plotë të urdhërimeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, vlerëson si më poshtë:

Kodi Zgjedhor, dispozitat që rregullojnë mbi përbërjen e administratës zgjedhore, bazohen në parimin e përfshirjes, përfaqësimit të barazpeshuar politik mes partive politike të shumicës parlamentare dhe të opozitës parlamentare.

Referuar nenit 29 të Kodit Zgjedhor, dispozita kryesore referuese për këtë vendimarrje, përcaktimet “partia kryesore e shumicës parlamentare”, “partia kryesore e opozitës parlamentare”, “partia e dytë e shumicës parlamentare” dhe “partia e dytë e opozitës parlamentare”, janë të pa lidhura me ndonjë përcaktim tjetër në legjislacionin në fuqi sa i përket pozicionimit të partive politike, si parti të shumicës apo të opozitës parlamentare.

Ndryshimet e Kodit Zgjedhor me ligjin 101/2020, me parashikimet e nenit 183, paragrafi 8, rregulluan lidhur me përcaktimin e partive të shumicës parlamentare dhe partive të opozitës parlamentare duke përcaktuar kohën/momentin kur vlerësohet pozicioni i partisë politike, çeljen e Kuvendit menjëherë pas zgjedhjeve 2017.



Partia Social Demokrate, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 qershor 2017, nuk u grupua me asnjë parti politike për të konkurruar së bashku në zgjedhje, si dhe nuk u bashkua me asnjë parti politike në koalicion paszgjedhor. Pavarësisht kësaj, është fakt i njohur publikisht mbështetja që kjo parti politike ka treguar në votimin për votëbesimin e qeverisë së re/kabinetit qeveritar të formuar menjëherë pas zgjedhjeve të datës 25 qershor 2017 (neni 80, paragrafi 3, i ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”).

Për sa më sipër, bazuar në parashikimet e nenit 29, paragrafët 1 dhe 4, nenit 183, paragrafi 8, të Kodit Zgjedhor, vendimin nr. 555, datë 26.07.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017”, renditja e partive për efekt të ndarjes së vendeve në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021, do të jetë:

Partia Socialiste e Shqipërisë, parti kryesore e shumicës parlamentare, do të propozojë dy anëtarë në çdo KZAZ.

Partia Social Demokrate, parti e dytë e shumicës parlamentare do të propozojë një anëtar në çdo KZAZ.

Partia Demokratike, parti kryesore e opozitës parlamentare do të propozojë dy anëtarë në çdo KZAZ;

Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, parti e dytë e opozitës parlamentare do të propozojë një anëtar në çdo KZAZ.

Referuar parashikimeve të nenit 29, paragrafi 1, shkronja “b”, anëtari i shtatë në gjysmën e KZAZ-ve do të propozohet nga Partia Socialiste e Shqipërisë, partia e parë e shumicës parlamentare, kurse gjysma tjetër të KZAZ-ve nga Partia Demokratike, partia e parë e opozitës parlamentare.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 29, paragrafët 1 dhe 4, nenin 183, paragrafi 8, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

#### **VENDOSA:**

1. Në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, përbërja e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor do të jetë:



- a) Partia Socialiste e Shqipërisë do të propozojë dy anëtarë në çdo KZAZ;
  - b) Partia Social Demokrate do të propozojë një anëtar në çdo KZAZ;
  - c) Partia Demokratike do të propozojë dy anëtarë në çdo KZAZ;
  - ç) Partia Lëvizja Socialiste për Integrim do të propozojë një anëtar në çdo KZAZ.
2. Anëtari i shtatë do të propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga Partia Socialiste e Shqipërisë, parti e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër të KZAZ-ve nga Partia Demokratike, parti e parë e opozitës parlamentare, sipas rezultatit të shortit që do të hidhet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
3. Sekretari i KZAZ-së do të propozohet:
- a) nga Partia Socialiste e Shqipërisë në KZAZ-të, ku Partia Demokratike ka propozuar anëtarin e shtatë të KZAZ-së;
  - b) nga Partia Demokratike në KZAZ-të, ku Partia Socialiste ka propozuar anëtarin e shtatë të KZAZ-së;
4. Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Demokratike, Partia Social Demokrate, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, të paraqesin kandidaturat për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve brenda datës 11 janar 2021.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

